fshatin Bllatë të komunës së Kamenicës.

Sipas njoftimit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, i dyshuari M.E. aksidentalisht ka plagosur me armë shokun e tij.



## TË REJAT



QERIM KELMENDI

**E çuditshme: Gati 1 vit pasi u vra dhe u dogj, Qerim Kelmendit ia ndërron dikush foton në Facebook**



JETMIR RUDI

**U zhvesh dhe u lidh në mal, si e inskenoi 28-vjeçari nga Malisheva gjithë rrëmbimin e tij**




COVID-19

**Nga këto komuna janë rastet e reja me COVID-19**

"Ekziston dyshimi i bazuar se sot në rrugën e fshatit Bllatë në Kamenicë, i dyshuari M.E., 24 vjeçar nga pakujdesia ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve, në atë mënyrë që derisa kishte qenë në veturë me shokun e tij, të dëmtuarin Q.S., 20 vjeçar duke provuar revolen e llojit "Ekol", aksidentalisht ka shtënë brenda veturës, me ç'rast edhe e ka plagosur të dëmtuarin, i cili për shkak të lëndimeve trupore është dërguar për tretman mjekësor, në Spitalin Regjional në Gjilan dhe është jashtë rrezikut për jetë", njofton Prokuroria.

Sipas Prokurorisë, i dyshuari, pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, ka mbajtur në pronësi armë zjarri, e cila edhe është sekuestruar nga Policia.

Në njoftim thuhet se i dyshuari për këtë rast është ndaluar.